



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

KOMUNA KLINË

Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik

Nr. 060-24803/23

Klinë, datë: 27.07.2023

PROCES VERBAL

Nga Debati me Publikun në fshatin Zllakuqan, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët "ATË SHTJEFËN GJEÇOVI", bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Radulloc, Krushevë e Vogël, Berkovë, Leskoc, Ranoc, Pataqan, Shtupel, Gjurgjevik i Vogël, Binxhë dhe Grabc. Tubimi u mbajt me datë 20 qershor 2023 dhe filloi në orën 18:00, ku morën pjesë: 16 persona.

RENDI I DITES

1. Shqyrtimi i Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026.

Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën hyrëse e mori drejtori i drejtorisë së Financave, pas një përshëndetje për të gjithë të pranishmëve dhe falënderimit për pjesëmarrje, ka bërë prezantimin e Draft-Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026, si dokument tejet i rëndësishëm që duhet të diskutohet me qytetarë.

Kryetari Elezaj fillimisht falënderoi banorët e fshatrave pjesëmarrëse dhe theksoi se sivjet në Zllakuqan do të ndërtohen afër 80 mijë euro rruge e infrastrukturë nëntokësore. Ai për të diskutuar më shumë për projekte ju dha fjalën banorëve të pranishëm lidhur me nevojat e tyre.

DISKUTIMET DHE KËRKESAT

Kristina Lazri – Fshati Zllakuqan, Kërkesë për rinovimin e shkollës në fshatin Zllakuqan.

Kolë Rrapi – Fshati Ranoc, Kërkohe rinovimi i rrugës kryesore.

Lukë Gjoka – Fshati Zllakuqan, Kërkon një rrugë fushore që të shtrohet me zhavorr, sepse gjendja është e rëndë.

Gustin Tomaj – Fshati Pataqan, Kërkohet kyçja në rrugë në Pataqan dhe Radulloc.



Gjatë debatit me publikun, lidhur me Draft Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Klinës për vitet 2024-2026, në fshatin Zllakuqan, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët “ATË SHTJEFËN GJEÇOVI”, bashkërisht me banorët e lokaliteteve tjera afër Radulloc, Krushevë e Vogël, Berkovë, Leskoc, Ranoc, Pataqan, Shtupel, Gjurgjevik i Vogël, Binxhë dhe Grabc, pjesëmarrës kanë qenë 16 persona.

Shtojca Nr. 2 – Tabela e numrit të pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Femra	3
Meshkuj	13
Total:	16

Takimi përfundoi në orën 18:54.

Procesmbajtësi:
Nikson Daka


Klinë, datë: 27.06.2023

